



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Cnr.113/14

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN në përbërje nga gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike Njomza Pirku, në çështjen juridike të paditëses A. B. nga Prizreni, kundër të paditurit N. K. nga Prizreni, lidhur me kontestin e vërtetimit të pronësisë, pas mbajtjes së seancës kryesore, në prezencën e palëve më datën 18.12.2014 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e PA BAZUAR kërkesëpadia e paditëses A. B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri N. (M.) K., nga Prizreni pa kurrfarë baze juridike e mban në shfrytëzim dhe posedim një pjesë të ngastrës kadastrale 611-12, në vendin e quajtur “D.” dhe atë në sipërfaqe prej 16 m² dhe **OBLIGOHET** i padituri që të rrënoj murin e ndërtuar dhe këtë pjesë të paluajtshmërisë-sipërfaqen prej 16 m² t’ia dorëzoj paditëses në shfrytëzim dhe posedim të lirë.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë fillimisht ka paraqitur padi sipas dy bazave për pengim posedimi dhe dorëzim të paluajtshmërisë, mirëpo paditësja ndërkohë me parashtresë ka precizuar kërkesë padinë ashtu që ka kërkuar që i padituri t’ia liroj sipërfaqen e zënë prej 35 m² dhe të rrënoj murin e ndërtuar në këtë pjesë të paluajtshmërisë.

Në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare paditësja ka deklaruar: se mbetet në tërësi si në padi, precizimin e bërë duke propozuar që të administrohen provat e propozuara duke përfshirë dhe ekspertizën me ekspert, ndërsa në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj kërkesë padinë si të bazuar pasi që nga provat e administruara posaçërisht nga ekspertizat e ekspertit F. S. të datës 31.10.2014 dhe më pas të plotësuar më datën 25.11.2014 është vërtetuar padyshim se i padituri ka zënë sipërfaqen prej 16 m² të ngastrës kadastrale 611-12. Përkundër përpjekjeve që në këtë çështje të arrihet marrëveshje për kompensim ku çmimi i fundit për kompensim ka qenë 2.000 € i padituri nuk ka pranuar ashtu nuk i ka mbetur asgjë

vetëm të kërkoj nga gjykata mbrojtje gjyqësore duke kërkuar aprovimin e kërkesë padisë. I ka kërkuar shpenzimet procedurale, por nuk i ka specifikuar ato.

Në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare i padituri ka deklaruar: se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi duke kontestuar kërkesë padinë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara nuk vërtetohet baza juridike e kërkesë padisë përkundër faktit se ekspertizat përcaktojnë sipërfaqe të zëna për shkak se paraprakisht para vendosjes së murit ka pasur marrëveshje me paditësen andaj i propozon gjykatës refuzimin e kërkesë padisë. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë shikimin dhe leximin e raporteve të ekspertizave të datave 31.10.2014 dhe 25.11.2014, ka bërë leximin e çertifikatës pronësore lidhur më ngastrës kadastrale 00611-12 i datës 23.09.2014, ka bërë leximin e çertifikatës pronësore për A. B. e dt.27.08.2013 dhe ka bërë leximin e kontratës të shitblerjes LRP nr... i datës 27.12.2013 dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke refuzuar kërkesë padinë pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga shikimi dhe leximi i ekspertizave të ekspertit, gjykata vërteton faktin se i padituri ka ndërtuar murin nga bllokat e betonit në lartësi prej 0.80 m2 dhe në gjatësi prej 20 m dhe sipërfaqja e zënë është 16 m2 me dimensione nga veriu 20.21 m, jugu 20.24 m, lindja 0.45 m dhe perëndimi 1.13 m. Ndërsa me ekspertizën plotësuese të datës 25.11.2014 eksperti ka llogarit tërë sipërfaqen në ngastrën kadastrale 611-12 në tërë gjatësinë e ngastrës sipas drejtimit të murit të ngritur dhe kjo sipërfaqe është 26 m2 sipas dimensioneve prej nga veriu 28.51, jugu 28.63, lindja 0.45 m dhe perëndimi 1.41 m. Eksperti në vazhdim sqaron se ngastra kadastrale 611-12 me nga $\frac{1}{2}$ evidentohet në emër të U. dhe F. P. në bazë të kontratës noteriale LPR nr... të datës 27.12.2013, ndërsa ngastra kadastrale 612-2 në të cilën jeton i padituri evidentohet në emër të D. N.

Nga leximi i çertifikatës pronësore 18-25760 e datës 23.09.2014 gjykata vërteton faktin se ngastra kadastrale kontestuese 00611-12 në sipërfaqe prej 725 m2 evidentohet në pjesë ideale me nga $\frac{1}{2}$ në emër të U. dhe F. P.

Nga leximi i çertifikatës pronësore të datës 27.08.2013 gjykata vërteton faktin se ngastra kadastrale kontestuese 00611-12 në sipërfaqe prej 725 m2 deri në momentin e lëshimit të kësaj çertifikate evidentohet në emër të paditëses.

Nga leximi i kontratës të shitblerjes LRP nr... i datës 27.12.2013 gjykata vërteton faktin se kemi të bëjmë me kontratë noteriale të shitblerjes në bazë të cilës ngastra kadastrale kontestuese 00611-12 në sipërfaqe prej 725 m2 është shitur nga paditësja për çmimin prej 50.200 € të cilën ngastër e kanë blerë blerësit U. dhe F. P. dhe kanë fituar pronësinë me $\frac{1}{2}$ mbi këtë ngastër.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se i padituri nuk është pronar i ngastrës kadastrale 612-2 pasi që ajo evidentohet në emër të D. N., po ashtu nuk është kontestues fakti se i padituri në pjesën e ngastrës kadastrale 611-12 ka ndërtuar murin nga bllokat e betonit dhe ka zënë sipërfaqen prej 16 m², ndërsa tërë sipërfaqja në drejtimin e murit është 26 m², por për gjykatën mbetet kontestues fakti se paditësja a ka legjitimacion real aktiv në këtë çështje juridike. Duke pasur për bazë faktin se paditësja më datën 05.02.2014 ka dorëzuar padinë në gjykatë, ndërsa më parashtrësën e datës 02.07.2014 ka precizuar kërkesë padinë të cilat fakte janë notore dhe vërtetohen nga vultat e pranimit në gjykatë dhe në anën tjetër duke marr për bazë faktin tjetër se me anë të kontratës noteriale nr.... të datës 27.12.2013 paditësja ngastrën kadastrale kontestuese ia ka shitur U. dhe F. P. i cili fakt vërtetohet në bazë të kësaj kontrate dhe certifikatës pronësore nr.18-25760 gjykata konstaton faktin se paditësja nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë nuk ka legjitimitet real aktiv pasi që paraprakisht më datën 27.12.2013 ngastrën kadastrale kontestuese ia ka shitur dy personave tjerë të cilët janë bashkëpronar në pjesë ideale me ½ e të cilët janë të legjitimuar real, andaj duke pasur për bazë këtë gjendje faktike gjykata ka refuzuar kërkesë padinë e paditësës për shkak të mungesës se legjitimacionit real aktiv.

Lidhur me shpenzimet gjykata vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta, konform nenit 450 të LPK-së për shkak se paditësja e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga arsyerat e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Cnr.113/14 të dt.18.12.2014

Sekretarja juridike
Njomza Pirku

Gjyqtari
Shaban Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.